



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 597, datë 02.12.2020

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen gjyqësore me paditës: {...}; të paditur: Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Presidenti i Republikës, Avokati i Popullit, person i tretë: Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar; objekti: “Shfuqizimin e pjesshëm të vendimit me pasojë pavlefshmërinë {...}, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për ndalimin e kandidimit të {...}, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019” vetëm për sa i përket ndalimit të kandidimit për kriterin e integritetit të figurës si gjë e gjykuar (*ne bis in idem*). Detyrimin e palës së paditur KED të përfundojë procedurën për {...} për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019 dhe për këtë shkak kalimin në procedurën e vlerësimit dhe të pikëzimit. Asgjësimin e shkresës së DSIK (në bazë të legjislacionit përkatës dhe rregullores së këtij institucioni si akt absolutisht i pavlefshëm). Sigurimin e padisë, pezullimin e procedurës së pikëzimit dhe vlerësimit deri në marrjen e këtij vendimi (neni 202-206 e 329 të Kodit të Procedurës Civile).

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR